



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 760/24 Dt. 12.12.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, Kryetari i Komunës së Prizrenit, me datë 12.12.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

- I. Me këtë Vendim synohet thjeshtimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Prizrenit.
- II. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
- III. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
- IV. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data 01 janar 2025.

Vendimi i dërgohet:

- Të gjithë drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet sipas Shtojcës 1
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Zyrës së Kryeministrit

Kryetari i Komunës



Shtojca 1: Shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Prizrenit

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	EMRI I DOKUMENTAVE QË NUK KËRKOHET MË PËR MARRJEN E SHËRBIMIT
DREJTORIA E ADMINISTRATËS		
1.	Ndërrimi i emrit personal	1. Vërtetim që personi nuk ka të kaluar kriminale 2. Ekstrakti i lindjes 3. Cerifikatë e lindjes 4. Vërtetim për pagesë të tatimit në pronë
2.	Ndërrimi i emrit personal për rastet e rikthimit të mbiemrit të vajzërisë / djalërisë pas shkurorëzimit	1. Vërtetim që personi nuk ka të kaluar kriminale 2. Ekstrakti i lindjes 3. Cerifikatë e lindjes 4. Vërtetim për pagesë të tatimit në pronë
3.	Korrigjimi i emrit personal	1. Ekstrakti i lindjes 2. Cerifikatë e lindjes 3. Certifikata e martesës 4. Vërtetim që personi nuk ka të kaluar
4.	Korrigjimi dhe plotësimi në dokumentet e arkivuara	1. Kopja e regjistrit themelar të lindjes, martesës, vdekjes
5.	Regjistrimet e mëvonshme të lindurve jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të Republikës së Kosovës që kanë kaluar moshën 12 vjeçare	1. Raporti mjekësor i fëmiut
6.	Regjistrimet e mëvonshme të lindurve që nuk mund të ofrojnë asnjë dëshmi	1. Raporti mjekësor i fëmiut
7.	Regjistrimet e mëvonshme të lindurve jashtë territorit të Republikës së Kosovës që nuk janë regjistruar në shtetin e lindjes	1. Raporti mjekësor i fëmiut 2. Proces verbal për pranimin e atësisë-amësisë për fëmijët e lindur jashtë martesës 3. Deklarata personale e prindërve dhe dëshmitarëve

8.	Regjistrimet e mëvonshme të lindurve në institucionet shëndetësore që kanë kaluar afatin ligjor 30/tridhjetë ditë	1.Certifikata e martesës së prindërve
9.	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të Kosovës	1.Raporti mjekësor
10.	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes në institucionet shëndetësore brenda territorit të Kosovës	1.Deklarata e dy dëshmitarëve që e kanë parë me sy të vdekurin ose e kanë bërë identifikimin e kufomës

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

11.	Pëlqim për gjërmim/dëmtim të rrugëve dhe sipërfaqeve të gjelbërta:	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
12.	Taksa për gjërmim/dëmtim të rrugëve me asfalt	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
13.	Leje për taxi individual	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
14.	Vazhdimi i lejes për taxi (pagesë vjetore)	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
15.	Leje për hyrje në shatërvan (vetëm për biznese)	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave 3. Letërnjoftimi
16.	Shfrytëzimi i hapësirës publike me orman dhe pajisje tjera për energjetikë dhe telekomunikim	1.Vërtetim për pagesë të tatimit në pronë 2.Vërtetim për pagesë të mbeturinave
17.	Leje për operatorë lokal për transport të udhëtarëve (pagesë çdo 5 vjet)	1.Letërnjoftimi i pronarit
18.	Leje për hyrje në shatërvan (vetëm për biznese)	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave

DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

19.1	Regjistrimi i pronësisë në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
20.2	Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë

		2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
21.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
22.	Përcaktimi i kufijve të parcelave:	1.Lista poseduese 2.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë i shitësit dhe blerësit 3.Kopja e planit 4.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave i shitësit dhe blerësit
23.	Bashkimi i parcelave	1.Lista poseduese 2.Kopja e planit 3.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë i shitësit dhe blerësit 4.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave i shitësit dhe blerësit
24.	Regjistrimi dhe modifikimi i servitutit:	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
25.	Fshirja e servitutit	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
26.	Regjistrimi i së drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtjes:	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
27.	Identifikimi i parcelave	1.Lista poseduese 2.Kopja e planit 3.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 4.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
28.	Korrigjimi i të dhënave kadastrale	1.Kopja e planit 2.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 3.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
29.	Lëshimi i të dhënave kadastrale në formë digjitale	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
30.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave

31.	Regjistrimi i bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë për çdo pronar 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave për çdo pronar
32.	Ndërrimi i kulturave të parcelave	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
33.	Historian për njësinë kadastrale	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
34.	Kopja e planit	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
35.	Certifikata e pronësisë	1.Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE		
36.	Vërtetim që personi nuk është nën kujdestari (për punësim) dhe aplikim në oden e avokateve)	1.Certifikata e mjekut
37.	Vërtetim që personi nuk merr ndihmë sociale	1.Certifikata e bashkësisë familjare
DREJTORIA E INSPEKTORIAETEVE		
38.	Kërkesë për inspektim para dhe pas thërjes së kafshëve	1.Hiqet nga lista e shërbimeve
39.	Pëlqim rreth plotësimin të kushteve minimale sanitare të bizneseve individuale dhe shoqërive tregtare	1.Hiqet nga lista e shërbimeve
DREJTORIA E URBANIZIMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINORE		
40.	Leje për vendosjen e përkohshme të objekteve të ndryshme në hapësirat publike	1.Vërtetimi i pagesës së mbeturinave